

VENDIM
Nr. 4, datë 20.6.2019

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË KUTIVE, DOSJEVE DHE MJETEVE
KANCELARIKE TË DETYRUESHME PËR ZBATIM NGA TË GJITHA
INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Mbështetur në pikën 1, të nenit 25, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, dhe gërmës “e”, të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, “Për miratimin e rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave’”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave,

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive, të dosjeve dhe mjeteve kancelarike, që ndikojnë te cilësia dhe jetëgjatësia e dokumentit, të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet publike mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

3. Ngarkohen të gjitha autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ARKIVAVE
Ardit Bido

**STANDARDET E KUTIVE, DOSJEVE DHE MJETEVE KANCELARIKE, QË
NDIKOJNË TEK CILËSIA DHE JETËGJATËSIA E DOKUMENTIT, TË DETYRUESHME
PËR ZBATIM NGA TË GJITHA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Lloji	Përmasat	Standardet
Kuti normale	40x28x18	- Materiali që duhet të përdoret duhet të jetë karton 2500 g/m². - Kutia përbëhet nga 2 kapakë, të gjitha këndet vijosen dhe janë 90 gradë, të gjitha brinjët lidhen me beze importi prapikot, për të realizuar një ngjitje dhe mbyllje sa më të mirë të kapakut që të bëjë të mundur sigurimin e fortësisë së nevojshme për t’u mos u shkëputur gjatë përdorimit. - Kutia vishet me syprinë njëngjyrëshe 70–80 g/m², kapaku në pjesën ballore duhet të ketë të vendosur një unazë që bën të mundur ajrosjen e dokumenteve brenda në kuti, por edhe për lehtësi tërheqje gjatë përdorimit, kjo e dubluar dhe me vendosjen e një lidhëseje në pjesën e poshtme të kutisë.
Kuti normale për amza	40x55x18	
Kuti normale për regjistra	40x70x9	
Dosje normale	37x26	Kartoni të jetë 400 gr/m ² , me 2 llapa, llapa brenda e palosur 20 cm, pjesa ballore me kthim pa ngjitje.

Stilolapsi		Në dokumentet zyrtare duhet të përdoret gjithmonë stilolaps cilësor në ngjyrë blu dhe majë metalike. Bojë rezistente ndaj dritës dhe ujit.
-------------------	--	--